



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 697/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lumturije Bytyqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Lipjan paraqitur për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Lumturije Bytyqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Lipjan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 06.11.2013, nga Lumturije Bytyqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Lipjan, në të cilën pretendohet se në vendvotimin me nr.1305E, në fshatin Kraisht dhe vendvotimin 1,2 dhe 3 komisionerët nuk i kanë shënuar votat e kandidatëve, dhe unë jam e dëmtuar sepse votat e kandidatit më nr.06, janë shkuar kandidatëve tjerë, andaj kërkoj që të rinumërohen të gjitha votat e PDK-së në këto qendra votuese, thuhet në pretendimet e ankimore.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një

vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve te vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtroi ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim te nenit 118.1 te LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat te cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund ti hidh poshtë (si te palejuar, të parregullta apo te pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 697/2013 më datën 08.11.2013



**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.